

Tiranë më 12.07.2021

**AKT THEMELIMI DHE STATUT  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**ARK HOTEL SHPK**

Në bazë e në zbatim të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” më poshtë referohet si “Ligji Për Shoqëritë”, veprimtaria e shoqërisë **ARK HOTEL SHPK** do të organizohet dhe do të drejtohet sipas këtij Statuti të trajtuar në të njëjtën dokument me Aktin e Themelimit.

**PJESA E PARË  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Ortakët**

1.1 Ortakët e shoqërisë janë:

**Shpëtim Shijaku**, i biri i **Sulejmanit**, shtetas shiptar, lindur ne Kruje dhe banues në Tirane me datë me 01/05/1962, mbajtës i Leternjofimit Nr.033855702, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 1 kuote, e cila korrespondon me **33,33%** të kapitalit të shoqërisë;

**Bilal Shijaku**, i biri i **Sulejmanit**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Arrameras me datë 01/10/1963, mbajtës i Letërnjofimit Nr. 036121830, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 1 kuote, e cila korrespondon me **33,33%** të kapitalit të shoqërisë;

**Petrit Shijaku**, i biri i **Sulejmanit**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Arrameras, me datë 15/04/1959, mbajtës i Letërnjofimit Nr. 036121694, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotërues i 1 kuote, e cila korrespondon me **33,34%** të kapitalit të shoqërisë.

**Neni 2  
Emri**

2.1 Emri i shoqërisë është “**Ark Hotel**” sh.p.k, (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

**Neni 3  
Selia e Shoqërisë**

3.1 Selia e Shoqërise është në adresën Nikel, Rinas, ARK Hotel Tirana Airport, prane bustit Nene Tereza.

- 3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Neni 4**  
**Forma ligjore**

- 4.1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

- 5.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar për një periudhë kohe të pacaktuar.

**Neni 6**  
**Objekti i aktivitetit**

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
- a. Ndertim i objekteve të ndryshme civile dhe industriale; rikonstruksione dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash; ndertim rrugesh, autostrada, punime nentokesore, ura, vepra arti, mbikalime, nenkalime, diga dhe tunele hidroteknike, pista aeroportuale, ujesjelles, gazsjelles, kanalizime, vepra kulluese e vaditese; ndertim fshatrash turistike. Ndertime detare dhe punime thellimi në ujë, pastrim i ujerave detare, liqenore dhe lumore. Punim, mbrojtje lumore, sistemime hidroteknike dhe bonifikime, ndertim impiantesh për prodhim energjie elektrike, ndertim i nenstacioneve, kabinave dhe transformatoreve, linja të TN të mesëm e të lartë, impiante hidrosanitare, kuzhine e lavanteri, impiante ngrites dhe transportues, ashensor, (shkallë levizese), ndertim impiante termik dhe të kondicionimit, ndertime parafabrikat, betonarme, strukture metalike dhe druri, impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, sinjalistika Ndertim i impiantit të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Shpime gjeologjiko-inxhinierike, puse e shpime për ujë. Punime për prishjen e ndertimeve të të gjitha llojeve. Import-eksport të mallrave industriale, ushqimor, të ndertimit, si dhe tregtimin e tyre me shumicë e pakicë. Prodhim inertesh si gur, rere, zhavorr etj me mjete mekanike dhe eksplozive plases dhe shperthyes. Pike shitje karburanti. Tregtim i pjeseve të kembimit për automjete e makineri. Transport për mallra e pasagjere brenda dhe jashtë vendit si dhe servis për automjete. Veprimtari dhe sherbime në fushën energjitike, por pa u kufizuar në to, ndertimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve, prodhimin e shitjen brenda e jashtë vendit të energjisë elektrike, Veprimtari për shfrytëzimin e karrierve dhe guroreve, shfrytëzimin e lendeve plasese, shfrytëzimin dhe kultivimin e lendes drusore, pyjeve, druveve frutore, kultivimin e bimeve mjekesore, shfrytëzimin e tokave bujqesore, ndertim serash, komplekse blegtorale.

- a. Veprimtari dhe shërbime ne hapjen e institucioneve arsimore
  - b. Veprimtari dhe shërbime hotelerie që lidhen me akomodimin në hotel dhe turizmi, shërbime restorantesh, organizime festash, ceremoni zyrtare, konferenca, seminare, trajnime, panaiere, organizime eventesh, takime biznesi, aktivitete kulturore dhe argetuese;
  - c. Bar dhe restorant, pishinë, sauna, fitness, shërbime banketi, shërbime transporti, shërbim parkimi;
  - d. Linja prodhimi në fushën e artikujve ushqimore, duke përfshirë prodhimin e të gjithë llojeve të artikujve ushqimore, si dhe furrë buke, pasticeri, konservim i artikujve ushqimor, etj.
  - e. Dhoma frigoriferike, tregti me shumice e artikujve industrial dhe bujqesor, etj.
- 6.2. Kryerjen e cdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm që ka lidhje të drejtëpërdrejtë ose jo me përmbushjen e objektit të sipërpermendur të shoqërisë.

## PJESA II KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT

### Neni 7 Kapitali i Shoqërisë

- 7.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100 000 (Njëqind mijë) Lekë. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3 kuota. Vlera nominale e kuotave të zotëruara nga Ortakët e Shoqërisë është përkatësisht:
- **Shpëtim Shijaku**, zotërues i 1 kuote me vlerë prej 33 330 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) leke ekuivalente me 33,33% të kapitalit të Shoqërisë.
  - **Bilal Shijaku**, zotërues i 1 kuote me vlerë prej 33 330 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) Lekë, ekuivalente me 33,33% të kapitalit të Shoqërisë.
  - **Petrit Shijaku**, zotërues i 1 kuote me vlerë prej 33 340 (tridhjetë e tre mijë e treqind e dyzete) Lekë, ekuivalente me 33,34% të kapitalit të Shoqërisë.

## III. STRUKTURA DREJTUESE TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

### Neni 8 Përgjegjësia e kufizuar

- 8.1. Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.




**Neni 9**  
**Të drejtat e lidhura me çdo kuotë**

- 9.1. Çdo kuotë e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Transferimi i kuotave**

- 10.1 Me përjashtim të rastit kur me unanimitet Ortakët vendosin ndryshe, Ortakët nuk mund të vënë peng, barrë siguroese ose çfarëdolloj barre tjetër mbi kuotat e Shoqërisë.
- 10.2 Me përjashtim të rastit kur me unanimitet Ortakët vendosin ndryshe, nuk mund të transferohet e drejta e pronësisë mbi kuotat e Shoqërisë nga asnjëri prej Ortakëve tek palët e treta nëpërmjet *(i)* një akti dhurimi/ pa pagesë inter vivos, *(ii)* një akti shkëmbimi ( neni 757 i Kodit Civil), *(iii)* një kontributi në Shoqëri të treta ose *(iv)* çfarëdolloj akti tjetër që drejtëpërsëdrejti ose indirekt realizon transferimin e pronësisë së ortakëve të Shoqërisë tek të tretët.
- 10.3 Kuotat e Shoqërisë janë të transferueshme inter vivos, kundrejt pageses, sipas procedurës së përcaktuar nga paragrafët në vijim të këtij neni, duke konsideruar ndalimin/përjashtimin nga transferimi sipas pikës së mësipërme.
- 10.4 Ortaku që synon të transferojë të drejtën e pronësisë mbi kuotën që zotëron (në vijim "**Ortaku Shitës**"), duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim të gjithë Ortakët e tjerë (në vijim "**Ortakët e Tjerë**") nëpërmjet një letre rekomande me njoftim marrjeje (në vijim "**Njoftimi**") të dërguar në adresën përkatëse të Ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë çmimin e kalimit të kuotës.
- 10.5 Ortakët e Tjerë do të kenë të drejtë të blejnë kuotën e ofruar, me të njëjtin çmim sikurse të përcaktuar në Njoftim. Nëse cilido prej Ortakëve të Tjerë synon të ushrojë të drejtën e parablerjes, duhet të njoftojë me shkrim Ortakun Shitës me letër rekomande me njoftim marrjeje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së Njoftimit. Në të kundërt, do të konsiderohet se është hequr dorë prej së drejtës së parablerjes.
- 10.6 Nëse më shumë se një prej Ortakëve të Tjerë ka ushtruar të drejtën e parablerjes, kuotat e ofruara do të blihen prej tyre në përpjesëtim me kuotat përkatëse që ata zotërojnë në Shoqëri me të njëjtat kushte dhe afate të propozuar nga i treti, Ortaku Shitës.



- 10.7 Nëse asnjë prej Ortakët të Tjerë nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të sipërshënuar, Ortaku Shitës do të jetë i lirë të shesë/transferojë tek i treti kuotën e përcaktuar në Njoftim, i cili duhet të përmbajë: (i) emrin e të tretit blerës, (ii) çmimin për transferimin e kuotës. Transferimi i kuotës së zotëruar nga ortaku do të kryhet vetëm pas miratimit unanimit nga Asambleja të cmimit të shitjes, i cili nuk duhet të jetë më i ulët nga ai i përcaktuar mesiper. Miratimi nga Asambleja nuk do të vonohet apo pengohet pa shkaqe të arsyeshme, të cilat mund të lidhen vetëm me rregullsinë e transaksionit.
- 10.8 Kushtet e parashikuara më sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një Ortak tek një pasardhës ose paraardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkëshorti, nëse është dhënë pëlqimi me shkrim nga të gjithë Ortakët e shoqërisë. Në këtë Statut, fjala “kontroll” ka të njëjtin kuptim të përdorur në ligjin tregtar.



### **Neni 11 Detyrimet e Ortakëve**

- 11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

## **PJESA IV ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

### **Neni 12 Të drejtat e asamblesë së përgjithshme**

- 12.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm asambleja e përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
  - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
  - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionit të dhënë nga ortakët;
  - (d) riorganizimin, bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
  - (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
  - (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
  - (g) pjesetimin dhe anulimin e kuotave;



- (h) perfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- (i) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- (j) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (k) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (l) të vendosë për investimet;
- (m) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (n) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe drejtuesit ekzekutivë të shoqërisë;
- (o) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (p) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël të autorizuar;
- (q) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- (r) përcaktimin e shpërblimeve për likujduesit, ekspertët kontabël;
- (s) mbikqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët;
- (t) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes së asamblese;
- (u) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (v) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (w) miratimin e cdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

12.4 Asambleja e përgjithshme do të ketë të drejtë të vendosë mbi cdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

### **Neni 13**

#### **Vendimet e asamblesë së përgjithshme**

13.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

13.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 % për qind të kuotave. Asambleja e Përgjithshme vendos me 51 % e votave të ortakëve pjesëmarrës, në lidhje me çështje për të cilat ligji dhe/ose ky Statut nuk kërkon një shumicë të kualifikuar të përcaktuar në pikën 13.5. më poshtë.

13.3 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas pikës 13.5. të këtij Statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë 100 % të numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike.

13.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

13.5 Vendimet e mëposhtme do të konsiderohen Vendime Strategjike për veprimtarinë e Shoqërisë dhe do të jenë të vlefshme vetëm nëse për to votojnë Pro Ortakët që veçmas ose bashkarisht përfaqësojnë **të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind)** të kapitalit themeltar të saj ose  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës.:

- i. Ndryshimin e këtij Statuti dhe Akti Themelimi;
- ii. Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- iii. Shpërndarjen e fitimeve (dividenti) dhe mbulimin e humbjeve;
- iv. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- v. Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve të Shoqërisë dhe të Drejtuesve të Lartë të Shoqërisë në pozicionet e mëposhtme:

- Drejtuesi i departamentit të Financës;

- vi. Miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë;
- vii. Miratimin e investimeve;
- viii. Shitjen, dhurimin, dhënien me qira apo disponimi në çdo formë i pasurisë së paluajtshme të Shoqërisë;
- ix. Shitjen, dhurimin, dhënien me qira apo disponimi të pasurive të luajtshme, që bëjnë pjesë në aktivet e shoqërisë, me vlerë mbi 100.000 (njqind mijë) euro
- x. Çdo financim nga bankat apo institucionet e tjera financiare;
- xi. Vendosjen peng apo kolateral të kuotave në Shoqëri si dhe vendosjen peng apo kolateral të çdo pasurie të Shoqërisë;

13.6 Në rastet kur Ortakët nuk marrin vendim në lidhje me çështjet e parashikuara nga neni 13.5., të konsideruara Vendime Strategjike, për të cilat kërkohet vendimarrje me shumicë të kualifikuar dhe votohen në Asamblesë të Ortakëve, Shoqëria konsiderohet të ndodhet para rastit të ashtuquajtur Bllokim në Vendimarrje ("**Bllokim Vendimarrjeje**"). Në këtë rast, Ortakët angazhohen dhe bien dakord të caktojnë një mbledhje të dytë të Asamblesë së Përgjithshme, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e Mbledhjes së mëparshme, ku të merren dhe një herë në shqyrtim çështjet për të cilat pati Bllokim Vendimarrjeje në mbledhjen e mëparshme të Asamblesë së Përgjithshme.

13.7 Nëse vendimi nuk merret me nga Asambleja e Ortakëve që veçmas ose bashkarisht përfaqësojnë **të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind)** të kapitalit themeltar të saj ose  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve pjesëmarrës, caktohet një mbledhje e tretë e Asamblesë, jo më

vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e Mbledhjes së mëparshme, ku do të shqyrtohen çështjet, për të cilat duhet të votojnë në favor të vendimit, Ortakët e shoqërisë që, veçmas ose bashkarisht, përfaqësojnë **të paktën: 51% (pesëdhjetë e një përqind)** të kapitalit themeltar të saj ose shumicën e thjeshte të votave të ortakëve pjesëmarrës.

#### Neni 14

#### Thirrja e asamblesë së përgjithshme

- 14.1 Asambleja e përgjithshme do të thirret nga administratorët të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose në cdo vend tjetër nëse përcaktohet në njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorëve mund të përfshihen dhe çështjet e posacme të rendit të ditës.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve nëpërmjet një letre rekomande ose email jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Njoftimi i shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë së përgjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse të gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakëve, atëherë vendimet mund të merren dhe në mungesë të përmbushjes së kërkesave formale të caktuara më sipër nëse të gjithë ortakët janë dakord.

#### Neni 15

#### Vendimet e marra në asamblenë e përgjithshme

- 15.1 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e përgjithshme.
- 15.2 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblesë, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.3 Nëse mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret



përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 16**

#### **Drejtimi i mbledhjes së asamblese së përgjithshme**

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të caktohet nga ortakët.
- 16.2 Do të aprovohen apo refuzohen vetëm ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblesë. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japin pëlqimin e tyre.

#### **Neni 17**

#### **Procesverbali i mbledhjes së asamblese së përgjithshme**

- 17.1 Për çdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Procesverbalit i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.
- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

### **PJESA V**

### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 18**

#### **Administrimi i Shoqërisë**

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator, i cili do të përfaqësojë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të kufizojë tagrat e administratorit të shoqërisë.
- 18.2 Administratori mund të autorizojnë nëpërmjet një prokure të posaçme një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.

- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 18.5 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin Administratorëve, Administratori ka të drejtat e mëposhtme:

- administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- nënshkrimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave;
- nënshkrimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;
- punësimin dhe shkarkimin e stafit të shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë,
- mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- administrator është përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- administrator është përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një audit i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

18.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet si administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritjeje:

1. **Shpetim Shijaku**, i biri i **Sulejmanit**, shtetas shiptar, lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane, me dt. 01/05/1962 mbajtes i leternjofimit nr.033855702, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar .

## **PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET**

### **NENI 19 Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare**

19.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

19.2 Në fund të cdo viti financiar, administratori do të përmbushi detyrat e mëposhtme:

- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të asetëve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
- (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
- (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.

19.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

### **Neni 20**

#### **Fitimi i Shoqërisë**

20.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri.

20.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i

shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

## **PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

### **Neni 21 Prishja dhe likuidimi**

21.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:

- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
- (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
- (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
- (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

21.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e asetëve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

## **PJESA VIII TE PËRGJITHSHME**

### **Neni 22 Të përgjithshme**

22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përipiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.

22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.

22.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (kater) kopje origjinale.

### **ORTAKËT**

**BILAL SHIJAKU**

**SHPËTIM SHIJAKU**

**PETRIT SHIJAKU**